



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Drenasit/Glllogocit
Zyra e Kryetarit



01 Nr. 400/01-8037 dt. 27/02/ 2025

Në vështrim të nenit 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040, nenit 72 të Statutit të Komunës së Drenasit, nenit 49 të Ligjit nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Udhëzimit Administrativ (MAPL) nr.04/2023 për Administratë të Hapur në Komuna dhe në bazë të Memorandumit të Bashkëpunimit mes Projektit për Decentralizim dhe Mbështetje të Komunave (DEMOS) dhe Komunës së Drenasit nr.01.400/01-6434 i datës 12/02/2025 si dhe në bazë të kërkesës së organizatës Helvetas, projekti DEMOS për planifikimin e hershem buxhetor dhe organizimin e dëgjimeve buxhetore, Kryetari i Komunës merr këtë :

V E N D I M

Për Formimin e Grupit Punues për bashkëpunim me organizatën Helvetas, projekti DEMOS për organizimin dhe planifikimin e dëgjimeve buxhetore komunale për vitin 2026

I. Me këtë vendim emërohen anëtarët e Grupit Punues me këtë përbërje:

1. **Albulena Saliuku** – Drejtoreshë për Buxhet dhe Financa, Kryesuese e Grupit Punues
2. **Kushtrim Bajraktari** – Zyrtar Kryesor Financiar, anëtar
3. **Bekim Dobra** – Udhëheqës i Zyrës për Komunikim me Publikun, koordinator i konsultimeve publike – anëtar për hartimin e kalendarit të dëgjimeve buxhetore për KAB-in dhe për buxhetin si dhe pikë kontakti me projektin DEMOS. Publikimin e të gjitha njoftimeve/procesverbaleve e raporteve që dalin nga procesi i dëgjimeve buxhetore.
4. **Avdyll Mziu** – Këshilltar Politik, anëtar për hartimin e raporteve të dëgjimeve buxhetore për KAB-in dhe buxhetin vjetor.
5. **Fluida Nika** – Zyrtare e Lartë për Financa në Drejtorinë për Buxhet dhe Financa, anëtare për mbajtjen dhe hartimin e procesverbaleve të dëgjimeve buxhetore për KAB-in dhe buxhetin vjetor.
6. **Arton Hasani** – Zyrtar për Përkthime – anëtar për hartimin e njoftimeve përmes aplikacionit CANVA dhe aplikacioneve të tjera.
7. **Liridona Fejza-Ajazi** – Udhëheqëse e Zyrës së Kuvendit, anëtare për hartimin e procesverbalit dhe raportit të dëgjimeve buxhetore që mbahen nga Kuvendi.
8. **Liridona Durmishi** – Zyrtare nga Drejtoria e Infrastrukturës Lokale, anëtare për regjistrimin dhe përpilimin e kërkesave që dalin nga dëgjimet buxhetore lidhur me projektet infrastrukturore.
9. **Luljeta Nebihu** - Zyrtare e Financave nga Drejtoria e Financave, anëtare për regjistrimin dhe përpilimin e kërkesave që dalin nga dëgjimet buxhetore lidhur me projektet e shkollave.

AW

10. **Lumturije Kiqina** – Udhëheqëse e Sektorit për Shëndetësi e Mirëqenie Sociale në Drejtorinë e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, anëtare për regjistrimin dhe përpilimin e kërkesave që dalin nga dëgjimet buxhetore lidhur me projektet në shëndetësi.
 11. **Bislime Davorani** – Zyrtare në Drejtorinë e Shërbimeve Publike dhe Emergjencë, anëtare për regjistrimin dhe përpilimin e kërkesave që dalin nga dëgjimet buxhetore lidhur me projektet e shërbimeve publike.
 12. **Ekrem Franca** – U.D i Udhëheqësit për Kulturë në Drejtorinë për Kulturë, Rini dhe Sport, anëtare për regjistrimin dhe përpilimin e kërkesave që dalin nga dëgjimet buxhetore lidhur me subvencionet dhe projektet në DKRS.
 13. **Arberije Gllareva-Baliu** – Zyrtare në Drejtorinë për Bujqësi, anëtare për regjistrimin dhe përpilimin e kërkesave që dalin nga dëgjimet buxhetore lidhur me subvencionet në bujqësi.
 14. **Qendresë Xhema** – Zyrtare në Drejtorinë e Zhvillimit Ekonomik, anëtare për regjistrimin dhe përpilimin e kërkesave që dalin nga dëgjimet buxhetore lidhur me subvencionet në DBZHE.
- II. Grupi punues mbështet dhe bashkëpunon me organizatën sa i përket fushës së dëgjimeve buxhetore si përgjegjës për organizimin e dëgjimeve buxhetore komunale me qëllim nxitjen dhe sigurimin nga ana e autoriteteve lokale të pjesëmarrjes së qytetarëve dhe palëve të tjera të interesuara gjatë procesit të politikbërjes dhe vendimmarrjes në nivel lokal, të promovojë transparencë komunale, si dhe të ndikojë në zhvillimin e politikave të qëndrueshme në interes të përgjithshëm, duke mundësuar aplikimin e formave dhe teknikave më të përshtatshme për të kuptuar më lehtë përmbajtjen dhe ndikimin e pritur të tyre.
- III. Grupi Punues po ashtu identifikon grupet e qytetarëve përmes përdorimit të bazës së të dhënave komunale të grupeve të interesit. Përgatitë planin e dëgjimeve buxhetore për Kornizën Afatmesme Buxhetore dhe Buxhetin vjetor komunal, duke përfshirë në mes tjerash, përcaktimin e numrit të dëgjimeve buxhetore, vendin kohën dhe datën. Përgatitë materialet që janë të nevojshme gjatë dëgjimeve buxhetore, si; ftesat e personalizuara (nëse konsiderohet e nevojshme) apo ato që publikohen në ueb faqe e rrjete sociale të Komunës, modelin e procesverbalit të takimit, listën e pjesëmarrësve etj. Përgatitë informacionet për buxhetin që do t'i prezantohet qytetarëve gjatë dëgjimeve buxhetore (përfshirë buxhetin në dispozicion për projekte të reja) në një format të vizualizuar dhe lehtë të kuptueshëm për qytetarët.
- IV. Prezantimi i informacioneve të buxhetit (me theks të veçantë në paraqitjen transparente të buxheteve të disponueshme për konsultim me qytetarët për projekte të reja nga kategoria e investimeve kapitale). Ndarja e listave të pjesëmarrësve për nënshkrim. Mbajtja e procesverbaleve të takimit. Moderimi dhe fasilitimi/lehtësimi i dëgjimit buxhetor (me theks të veçantë në nxitjen e diskutimit dhe pranimin e ideve dhe kërkesave nga qytetarët, e po ashtu në nxitjen e validimit të kërkesave të qytetarëve nga komuniteti i pranishëm në dëgjim buxhetor, sidomos atyre që në bazë të argumentimit konsiderohen se janë prioritare dhe urgjente për tu realizuar).

- V. Përpilimi i kriterëve/arsyeve për shqyrtimin e kërkesave të qytetarëve dhe kategorizimit e prioritizimit për pranimin dhe refuzimin e tyre. Shqyrtimi i të gjitha kërkesave të pranura gjatë dëgjimeve buxhetore dhe të tjera që pranohen me shkrim (rrjete sociale, email, uebfaqe) apo forma të tjera si takime të rregullta me Kryetarët apo të ngjashme. Hartimi i një raporti të detajuar të konsultimeve publike ku evidentohen dhe elaborohen të gjitha kërkesat e pranura të qytetarëve dhe jo vetëm ato të pranura fizikisht gjatë dëgjimeve buxhetore. Publikimi i raportit të konsultimeve publike në faqen e internetit të komunës dhe sipas kërkesave dhe afateve kohore të Udhëzimit Administrativ për Administratë të hapur.
- VI. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Komunës .



Kryetari i Komunës

Ramiz Lladrovci

Vendimi u dërgohet:

- *Zyrës së Kryetarit*
- *Zyrës së Personelit*
- *Anëtarëve të Komisionit*
- *Arkivit të Komunës së Drenasit*